



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHAQIR TOTAJ **FAQE 4-5**

SYNOJ TË BËJ KOALICION ME TË GJITHA PARTITË OPOZITARE



Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë me dije se synon të bëjë koalicion me të gjitha partitë e opozitës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se bisedimet me këto subjekte politike po shkojnë mirë. Totaj ka shprehur bindje për fitore më 14 nëntor. Ai ka thënë se përkrahja e qytetarëve të kësaj komune e bën optimist se këtë herë do ta mposhtë kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Prizrenit, Mytsher Haskukën

RIHAPET TERMINALI DOGANOR I "TREPÇËS"



MOSNJOHJA E PLOTË E KOSOVËS, PENGESË DREJT NATO-S

Mosnjohja e Kosovës nga katër shtetet evropiane që janë pjesë e NATO-s është pengesa kryesore për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare, u tha në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë në Kuvendin e Kosovës. Lidhur me anëtarësimin e Kosovës në NATO, para anëtarëve të këtij komisioni ka raportuar të martën ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Sipas tij, Ministria e Mbrojtjes ka bashkëpunim të përditshëm me NATO-n dhe objektive të ministrisë që udhëheq ai është anëtarësimi në NATO



AKTUALE



LIDERËT BOTËRORË PREMTOJNË
T'I JAPIN FUND SHPYLLËZIMIT
DERI MË 2030 **F. 2**

GËRVALLA THOTË SE SHTETET QË
REFUZOJNË LIBERALIZIMIN E
VIZAVE KANË DYSHIME NË TEMAT
E SHTETIT LIGJOR **F. 5**


MINISTRIA E DREJTËSISË DO T'I
ULË TARIFAT E PËRMBARUESVE
PRIVATË **F. 7**

EKONOMI



ODAT AMERIKANE TË EVROPËS, TË
PËRKUSHTUARA PËR NDRYSHIMET
KLIMATIKE **F. 8**

SPORT



LIVERPOOLI KËRKON FITOREN
E DYTË NDAJ ATLETICOS,
MILANI KËRKON SHANSIN
E FUNDIT KUNDËR PORTOS **F. 11**

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht--Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Meta takon ministrin e Punëve të Jashtme italiane: Italia, partnere strategjike e Shqipërisë

ROMË, 2 NËNTOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka takuar në Romë ministrin e Punëve të Jashtme të Italisë, Luigi Di Maio, në kuadër të punimeve në konferencën

ndërkombëtare "Rrugë të reja për t'u përkujdesur - bota pas pandemisë së Covid-19". "Italia është një partnere strategjike e Shqipërisë, me rol proaktiv në mbështetje të

perspektivës sonë evropiane, marrëdhëniet e shkëlqyera tradicionale me të cilën meritojnë të fuqizohen më tej në të gjitha fushat. Komuniteti arbëresh dhe emigracioni

shqiptar në Itali, urë e rëndësishme për thellimin e bashkëpunimit mes dy vendeve", ka shkruar presidenti Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



Gazeta 'Guardian': Bosnja në rrezik të ndarjes dhe konfliktit

SARAJEVË, 2 NËNTOR - Përfaqësuesi i lartë i komunitetit ndërkombëtar në Bosnje e Hercegovinë, Christian Schmidt, paralajmëroi se ky vend është në rrezik të menjëhershëm për t'u shpërbërë dhe tha se ekzistojnë gjasa "shumë reale" për rikthimin e tij në konflikt. Në një raport për Kombet e Bashkuara, të parë nga gazeta britanike 'Guardian', Schmidt tha se nëse "separatistët serbë zbatojnë kërcënimet e tyre për rikrijimin e ushtrisë së tyre, duke i ndarë forcat e armatosura kombëtare në dysh", atëherë në Bosnje do të duhet të dërgohen më shumë paqeruajtës ndërkombëtarë, për ta ndaluar rrëshqitjen e



vendit drejt një lufte të re.

Detyrat paqeruajtëse ndërkombëtare në Bosnje aktualisht i ka një forcë e Bashkimit Evropian, e njohur si Eufor, që i ka rreth 700 trupa. NATO-ja ka një seli formale në

Sarajevë.

Në raportin e tij të parë që nga marrja e postit në muajin gusht, Schmidt tha se Bosnja po përballet me "kërcënimin më të madh ekzistencial të periudhës së pasluftës". "Mungesa e

përgjigjes ndaj situatës aktuale do ta rrezikojë [Marrëveshjen e Dejtonit], ndërsa paqëndrueshmëria në Bosnje do të kishte implikime më të gjera rajonale. Perspektivat për ndarje të mëtejshme dhe konflikt janë shumë reale", citon 'Guardian' përfaqësuesin ndërkombëtar Schmidt. Udhëheqësi serb i Bosnjës, Millorad Dodik, është duke kërcënuar me ndarjen e Republika Sërpskës - entitet i banuar me shumicë serbe - nga pjesa tjetër e Bosnjës. Ai, po ashtu, ka thënë serbët e Bosnjës do të tërhiqen nga ushtria e përbashkët e vendit dhe do të rikrijojnë një forcë serbe. Përfaqësuesit e Republikës

Sërpska janë duke e bojkotuar punën e institucioneve qendrore të Bosnjës që nga fundi i korrikut, kur paraardhësi i Schmidt, Valentin Inzko, ka vendosur një ligj që ndalon mohimin e gjenocidit dhe krimeve të tjera të luftës në Bosnje. Republika Sërpska ka refuzuar ta ndalojë me ligj mohimin e gjenocidit. Republika Sërpska së bashku me Federatën Myslimane-Kroate janë dy entitetet që përbëjnë Bosnje e Hercegovinë. Organizimi i tillë është bërë me të ashtuquajturën Marrëveshje e Dejtonit, e cila i ka dhënë fund luftës në Bosnje në vitet 1990.

Liderët botërorë premtojnë t'i japin fund shpyllëzimit deri më 2030

GLASGOU, 2 NËNTOR - Më shumë se 100 udhëheqës globalë që po marrin pjesë në konferencën e Kombeve të Bashkuara për klimën në Gllasgou të Skocisë priten të nënshkruajnë një zotim për të ndaluar dhe anuluar shpyllëzimin deri në vitin 2030.

Deklarata e përbashkët do të nënshkruhet gjatë bisedimeve për klimën, të njohura si COP26, nga liderët e vendeve që kolektivisht përbëjnë 85 për qind të pyjeve të botës, tha përmes një deklaratë zyra e kryeministrit britanik, Boris Johnson.

Në mesin e tyre janë: Brazili, Indonezia dhe Republika Demokratike e Kongos, të cilat kanë disa nga pyjet më të mëdha dhe më të rrezikuara në botë.

Ky është "hapi më i madh përpara në mbrojtjen e pyjeve të botës", thuhet në deklaratën e Johnsonit.

Zotimi do të mbështetet me premtimin për të siguruar 12 miliardë dollarë financa publike nga 12 vende deri në vitin 2025. "Kjo do t'i mbështesë aktivitetet në vendet në zhvillim, përfshirë restaurimin e tokës së

degraduar, do t'i trajtojë zjarret dhe do t'i përkrahë të drejtat e komuniteteve indigjene", thuhet në deklaratë.

Ekspertët e mirëpritën zotimin, por kujtuan se një marrëveshje e mëparshme në vitin 2014 "ka dështuar ta ngadalësojë shpyllëzimin". "Është një lajm i mirë që kemi një angazhim politik nga kaq shumë vende për t'i dhënë fund shpyllëzimit", tha Simon Lewis, ekspert për klimën dhe pyjet në Kolegjin Universitar të Londrës.

Por, bota "ka qenë këtu edhe më parë", me një deklaratë në Nju-Jork në vitin 2014, "e cila nuk ka arritur ta ngadalësojë shpyllëzimin fare", tha ai.

Rreth 7.2 miliardë dollarë shtesë do të vijnë nga financimi i sektorit privat. Drejtorë ekzekutivë nga më shumë se 30 institucione financiare do të angazhohen për t'i eliminuar investimet në aktivitetet që lidhen me shpyllëzimin.

Kryeministri Boris Johnson tha se "premtimet e papara" nënkuptojnë që bota "do të ketë shans për t'i dhënë fund historisë së gjatë të njerëzimit si pushtues i natyrës dhe, në vend të kësaj, njeriu do të



bëhet kujdestar i saj".

Pyjet janë zhdukur me shpejtësi në mbarë botën, pasi drunjtë priten për të mbështetur bujqësinë dhe ndërtimin.

Aktivitetet e mjedisit duan që shkatërrimi të ndalet, sepse pyjet thithin emetimet e dyoksidit të karbonit dhe në këtë mënyrë nxjerrin nga atmosfera një nga gazrat kryesor që kontribuojnë në ngrohjen globale.

Sipas Vëzhguesit Global të

Pyjeve, bota ka humbur 258 000 kilometra katrorë pyje në vitin 2020. Kjo është një hapësirë më e madhe se Mbretëria e Bashkuar.

Aktualisht, një sipërfaqe pylli me madhësinë e 27 fushave të futbollit humbet çdo minutë. Pesë vende: Britania, Shtetet e Bashkuara, Norvegjia, Gjermania dhe Holanda - si dhe disa financues privatë - do të zotohen për ndarjen e 1.7 miliard dollarëve për ta mbështetur ruajtjen e pyjeve

nga njerëzit indigjenë.

Ambientalistët thonë se komunitetet indigjene janë mbrojtësit më të mirë të pyjeve kundër prerësve.

Bisedimet në Gllasgou synojnë të mbajnë gjallë një objektivi për kufizimin e ngrohjes globale në 1.5 gradë celsius deri në fund të shekullit. Shkencëtarët thonë se pyjet dhe të ashtuquajturat zgjidhje të bazuara në natyrë do të jenë jetike për arritjen e këtij qëllimi. (rel)

FLET PËR “EPOKËN E RE”, SHAQIR TOTAJ

Synoj të bëj koalicion me të gjitha partitë opozitare

Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë me dije se synon të bëjë koalicion me të gjitha partitë e opozitës. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se bisedimet me këto subjekte politike po shkojnë mirë. Totaj ka shprehur bindje për fitore më 14 nëntor. Ai ka thënë se përkrahja e qytetarëve të kësaj komune e bën optimist se këtë herë do ta mposhtë kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Prizrenit, Mytaher Haskukën

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryetar të komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka shprehur bindjen për fitore më 14 nëntor. Ai ka deklaruar se përkrahja e madhe e qytetarëve të kësaj komune që po merr çdo ditë e bën optimist se këtë herë do ta mposhtë kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetar të Prizrenit, Mytaher Haskuka, i cili është kryetar aktual i kësaj komune.

Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Totaj ka treguar për dallimet e tij me kundërkandidatin. “Qytetarët tashmë e kanë kuptuar se z. Haskuka ka treguar deficite serioze në menaxhim të Prizrenit dhe pasojat janë të pranishme tash e katër vjet, kurse unë jam një profesionist i dëshmuar i menaxhmentit dhe institucionalist”, ka thënë Totaj. Ai ka thënë se synon të bëjë koalicion me të gjitha partitë shqiptare që nuk janë në balotazh. Sipas Totajt,

bisedimet me këto parti janë duke ecur mirë. “Bisedimet me partitë e tjera që nuk janë në balotazh po shkojnë mirë dhe unë jam optimist për një bashkëpunim konkret deri te fitorja dhe pas fitores. Opinionin do ta informojmë me kohë”, ka deklaruar Totaj. Në këtë intervistë Totaj ka treguar për prioritetet e tij kryesore nëse vjen në krye të Prizrenit. “Menaxhimi i mirë i resurseve humane dhe i buxhetit si dhe transparenca dhe llogaridhënia”, ka thënë Totaj.

“Epoka e re”: Z. Totaj, e diela e 14 nëntorit do të jetë hera e katërt që do të përballeni me z. Haskuka në garën për kryetar të Prizrenit. Çfarë ju shtyn të besoni se këtë herë do të fitoni?

Totaj: Përkrahja në rritje nga ana e qytetarëve të Prizrenit më bën optimist.

“Epoka e re”: Pse qytetarët e kësaj komune duhet të votojnë për ju dhe jo për kryetarin aktual Mytaher Haskuka?

Totaj: Qytetarët tashmë e kanë



kuptuar se z. Haskuka ka treguar deficite serioze në menaxhim të Prizrenit dhe pasojat janë të pranishme tash e katër vjet, kurse unë jam profesionist i dëshmuar i menaxhmentit dhe institucionalist.

“Epoka e re”: Cilat janë prioritetet tuaja kryesore që synoni t'i realizoni pasi të bëheni kryetar?

Totaj: Menaxhimi i mirë i resurseve humane dhe i buxhetit si dhe transparenca dhe llogaridhënia.

“Epoka e re”: Kundërkandidati juaj tashmë ka bërë koalicionin e parë për balotazh. Ju keni menduar për ndonjë koalicion para balotazhit?

Totaj: Bisedimet me partitë e tjera që nuk janë në balotazh po shkojnë mirë dhe unë jam optimist për një bashkëpunim konkret deri te fitorja dhe pas fitores. Opinionin do ta informojmë me kohë.

“Epoka e re”: Më 17 tetor është parë se LDK-ja, AAK-ja dhe Nisma kanë elektorat të konsiderueshëm. Me cilën nga këto parti pëlqeni të bëni koalicion?

Totaj: Nuk kam limite për

bashkëpunim dhe të gjitha partitë tentoj t'i bind të më përkrahin. Do të shohim.

“Epoka e re”: Gjatë kësaj kohe kemi parë që kundërkandidatit tuaj po i del në krah kryeministri dhe disa ministra duke premtuar projekte të ndryshme për këtë komunë. Sa mund të ketë ndikim kjo në garën elektorale?

Totaj: Gara duhet të jetë mes dy kandidatëve e jo mes liderëve partiakë. Projektet e premtuara do të duhej të ishin për qytetin dhe jo për kandidatin. Si kryetar i ardhshëm do të bashkëpunoj me qeverinë për të mirën e Prizrenit.

Kryeministri përkujton heronjtë Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Kryeministri Albin Kurti ka bërë homazhe te varret e heronjve Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu në varrezat e heronjve në lagjen “Velania” të Prishtinës. Në 32-vjetorin e rënies së tyre, Kurti ka kujtuar vjeshtën e vitit 1989, kur Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu si veprimtarë ilegalë organizonin dhe merrnin pjesë në demonstratat e asaj kohe, që ishin edhe të fuqishme dhe të shpeshta. “Më datën 1 nëntor, një ditë para se të vriteshin, Afrim

Zhitia mban fjalim në demonstratë, ndërkaq më 2 nëntor, në lagjen ‘Bregu i Diellit’, në ballafaqim me forcat e Serbisë, bien heronjtë Afrim Zhitia dhe Fahri Fazliu. Është tejet interesante për historinë tonë, se si në vitet ‘80, pas vrasjes së vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës, Lëvizja e përjeton një hov të madh me organizimin brenda Kosovës, në radhë të parë duke iu falënderuar Afrimit dhe Fahriut, me ç’rast Afrimi ishte sekretar organizativ i

Lëvizjes”, ka thënë Kurti. Sipas tij, ata kanë bërë shumë aksione në atë kohë. “Tash, kur vjen puna te përfaqësuesit e popullit, janë dy lloj përfaqësuesish të popullit: janë përfaqësuesit demokratikë dhe përfaqësuesit historikë. Këto dy lloje nuk janë plotësisht të ndara, as të pavarura por, megjithatë, janë dy lloje. Pa dyshim që ndër përfaqësuesit më emblematikë të popullit në kuptimin historik të fjalës janë këta dy heronj të cilët janë të ngjashëm me dy



heronj të tjerë pesë vjet më herët në vitin 1984, Rexhep Mala e Nuhi Berisha që janë shprehje e popullit tonë si rezistencë e popullit tonë, si

një popull që nuk e duron shtypjen dhe padrejtësinë, që nuk e duron shfrytëzimin e pabarazisë”, është shprehur Kurti.



MINISTRI I MBROJTJES, ARMEND MEHAJ, KA RAPORTUAR PËR KOMISIONIN
PËR PUNË TË JASHTME DHE DIASPORË

Mosnjohja e plotë e Kosovës, pengesë drejt NATO-s

Mosnjohja e Kosovës nga katër shtetet evropiane që janë pjesë e NATO-s është pengesa kryesore për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare, u tha në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë në Kuvendin e Kosovës. Lidhur me anëtarësimin e Kosovës në NATO, para anëtarëve të këtij komisioni ka raportuar të martën ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Sipas tij, Ministria e Mbrojtjes ka bashkëpunim të përditshëm me NATO-n dhe objektivë e ministrisë që udhëheq ai është anëtarësimi në NATO

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Procesi i anëtarësimin të Kosovës në NATO ishte çështja për të cilën ka raportuar të martën ministri i Ministrisë së Mbrojtjes, Armend Mehaj, në mbledhjen e Komisionit për Punë të Jashtme dhe Diasporë, i kryesuar nga Haki Abazi, kryetar i këtij komisioni.

Mosnjohja e Kosovës nga katër shtete evropiane që janë edhe pjesë NATO-s është pengesa kryesore për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë ndërkombëtare, u tha në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë në Kuvendin e Kosovës. Sipas tij, Ministria e Mbrojtjes ka

bashkëpunim të përditshëm me NATO-n dhe objektivë e ministrisë që udhëheq ai është anëtarësimi në NATO.

Kosova, siç ka thënë ai, ka nënshkruar dhjetëra memorandume bashkëpunimi dhe marrëveshje të ndryshme me shtetet anëtare të NATO-s, kurse "127 pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës po ndjekin studime dhe trajnime jashtë vendit". Megjithatë, ministri Mehaj ka thënë se ka hapësirë që bashkëpunimi me NATO-n të thellohet. "Rrugën e Kosovës dhe të FSK-së për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare e lehtëson një kornizë ligjore e koordinuar me partnerët tanë. Në këtë drejtim e veçoj Projektligjin për dërgimin e FSK-së jashtë vendit", ka

deklaruar Mehaj.

Kosova, në bashkëpunim me forcat amerikane, ka dërguar në muajin mars një kontingjent të FSK-së në Kuvajt. Ka qenë ky misioni i parë i kësaj force jashtë Kosovës.

Gjatë raportimit të martën, deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Ariana Musliu-Shoshi, e pyeti ministrin Mehaj se cili është plani i Ministrisë së Mbrojtjes për anëtarësim në NATO, duke përmendur faktin se në bazë të rregullave dhe procedurave të NATO-s, Kosova nuk mund të anëtarësohet, pasi janë katër shtete që ende nuk e njohin pavarësinë e saj.

Spanja, Greqia, Sllovakia dhe Rumania nuk e njohin Kosovën shtet i pavarur. Lidhur me këtë,

Mehaj ka thënë se Kosova e ka të domosdoshme të ketë ambasador në NATO, por ka shtuar se procesi i zgjedhjes së tij nuk ka nisur.

Në raportimin para deputetëve në Komisionin për Punë të Jashtme, ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, ka thënë se Kosova po bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë për t'i parë mundësitë se në çfarë fazash mund të bëhet obligimi ushtarak për qytetarët e vendit në të ardhmen.

Mehaj u shpreh se përkohësisht plani është i hartuar për ushtri profesionale. "Besoj se është ëndërr e çdo qytetari të Kosovës që të kemi ushtri të mirëfilltë, por të jetë edhe mundësia që çdo individ të shërbejë në ushtrinë. Përkohësisht plani është i hartuar për ushtri profesionale, por ne jemi në koordinim me partnerët tanë për t'i parë mundësitë se në çfarë faza dhe mundësisht mund të bëhet obligative ushtria në të ardhmen. Duhet të marrim plane konkrete edhe të shteteve të tjera, si ato shtetet baltike që kanë kaluar të njëjtat

faza e me kërcënime nga Rusia siç ne kemi nga Serbia. Jemi në koordinim, por me më rëndësi është të theksohet se çdo veprim merret në koordinim me ShBA-në për përfitime të Kosovës", ka deklaruar Mehaj. Sipas tij, në Kosovë ka interesim të madh të të rinjve për t'u bërë ushtarë të Ushtrisë së Kosovës. "Për 400 pozitat që kishin hapur në konkursin e kaluar të FSK-së kishin aplikuar mbi 6 000 qytetarë, ndërsa deri tani në konkursin, i cili vazhdon të jetë i hapur për 840 rekrutë, kanë aplikuar mbi 1 100 qytetarë, ku prej tyre 100 janë gra", ka thënë Mehaj.

Në vijim të takimit ministri Mehaj u është përgjigjur pyetjeve dhe çështjeve të cilat u ngritën nga anëtarët e komisionit. Në fund të takimit kryetari i komisionit, Haki Abazi, si dhe anëtarët e tjerë, u zotuan për një bashkëpunim dhe mbështetje edhe më të theksuar gjatë së ardhmes, me qëllim të përmbushjes së objektivave të përbashkëta. Njohësi i çështjeve të sigurisë, Nuredin Ibishi, ka thënë për

“Radion Evropa e Lirë” se mosnjohja e Kosovës nga këto katër vende është pengesë për anëtarësim në NATO. Sipas tij, hyrja në partneritetin për paqe e jep një garanci për një kohë të caktuar që Kosova mund të futet në NATO. “Një e arritur e FSK-së që garanton një proces të përkrahjes së atyre vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën, me mbështetje të partnerëve tanë strategjikë, [është se] ne kemi kaluar prej misionit paqësor në mision ushtarak, siç ishte ky i

fundit me forcat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës”, ka deklaruar Ibishi. Sipas tij, FSK-ja ka ngritur një organizatë profesionale me standarde të miratuara të NATO-s dhe, duke rritur kapacitetet e saj, shtoi ai, mund të shkurtohet edhe periudha e tranzicionit, që është paraparë të zgjasë 10 vjet. Në dhjetor të vitit 2018 Kuvendi i Kosovës ka miratuar ndryshimet ligjore për ta transformuar mandatin e FSK-së në ushtri.

Si bëhet anëtarësimi në NATO?

“Politika e dverve të hapura” e NATO-s bazohet në dokumentin themelues të Aleancës, sipas të cilit, anëtarësimi në NATO është i hapur për çdo “shtet evropian që është në gjendje t’i çojë përpara parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut”. Sipas kësaj politike, çdo vendim

për zgjerimin duhet të merret “me marrëveshje unanime”.

Për t’u anëtarësuar në Aleancë, vendet pritet t’i respektojnë vlerat e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe t’i plotësojnë disa kriteret politike, ekonomike dhe ushtarake, të përcaktuara në Studimin e Zgjerimit, të vitit 1995.

Këto kriteret përfshijnë një sistem

politik demokratik bazuar në një ekonomi tregu, trajtim të drejtë të popullatës pakicë, angazhim për t’i zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore, aftësi dhe vullnet për të dhënë kontribut ushtarak në operacionet e NATO-s, si dhe përkushtim ndaj marrëdhënieve dhe institucioneve demokratike civilo-ushtarake.



Gërvalla thotë se shtetet që refuzojnë liberalizimin e vizave kanë dyshime në temat e shtetit ligjor

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, gjatë raportimit të saj në Komisionin për Integritet Evropian, ka folur për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën. “Çështja e regjimit të vizave jo që është e padrejtë, por është edhe e pashpjegueshme. Nëse konstatohet se qeveritë pararendëse i kanë plotësuar, pse vonohet. Ka ende vende skeptike. Mbetet që t’i identifikojmë faktorët. Ka shtete që na thonë se duhet forcuar sistemin ligjor. Duhet t’i bindim ato me rezultate konkrete”, ka thënë Gërvalla të martën. Ajo ka shtuar se një pjesë e shteteve anëtare të BE-së që e refuzojnë procesin e liberalizimit të vizave, thirren në tema të shtetit ligjor në sfera të ndryshme.

Gërvalla iu drejtua anëtarëve të Komisionit për Integritet, se si MPJD çdo ditë bën nga një hap drejt këtij procesi. “Ju garantoj se si MPJD nuk kalon asnjë ditë pa u bërë një hap i vogël drejt liberalizimit të vizave”, ka deklaruar Gërvalla. Ministria Gërvalla ka shtuar se në muajt dhe vitet e ardhshme çështja e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës do të forcohet dhe do të ketë një sërë aktivitetsh që do ta dëshmojnë këtë. Lidhur me anëtarësimin e



MPJD çdo ditë bën nga një hap drejt këtij procesi. “Ju garantoj se si MPJD nuk kalon asnjë ditë pa u bërë një hap i vogël drejt liberalizimit të vizave”, ka deklaruar Gërvalla. Ministria Gërvalla ka shtuar se në

muajt dhe vitet e ardhshme çështja e subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës do të forcohet dhe do të ketë një sërë aktivitetsh që do ta dëshmojnë këtë. Lidhur me anëtarësimin e

Kosovës në organizata ndërkombëtare, Gërvalla ka theksuar se do të bëhet në disa etapa dhe me një strategji të mirëfilltë. “Kosova ka nevojë për strategji të mirëfilltë se cilat janë organizatat ndërkombëtare për anëtarësim. Kemi interesa për fuqizim të subjektivitetit

ndërkombëtar, por edhe ndihmë qytetarëve”, ka theksuar ajo. Po ashtu, Gërvalla ka thënë se Greqia nuk e ka kushtëzuar njohjen me projektin e gazsjellësit. Lidhur me këtë temë ministria ka pohuar se duhet analiza më të mirëfillta për një vendimarrje.

Gërvalla e quan të dëmshme “Open Balkan” dhe asociacionin

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, e ka quajtur të dëmshme iniciativën për “Open Balkan” dhe themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe. “Vendimet në të kaluarën janë marrë me një lehtësi të jashtëzakonshme. ‘Open Balkan’ dhe asociacioni janë dy tema që i kemi analizuar dhe janë të dëmshme”, u shpreh Gërvalla. Ajo shtoi se themelimi i asociacionit krijon një Bosnje të dytë në Kosovë. “Asociacioni e krijon një Bosnje të dytë në Kosovë. Nuk duam të paralizohemi si Bosnja. Nuk e kemi luksin t’i zbatojmë marrëveshjet që janë të dëmshme”, ka thënë ajo para deputetëve gjatë raportimit në Komisionin për Integritet Evropian.

Kosova regjistron 21 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të martën janë regjistruar 21 raste me Covid-19 pas testimit të 1 651 mostrave. Në 24 orët e fundit nuk është regjistruar asnjë viktimë.

Autoritetet shëndetësore kanë thënë se më 2 nëntor 10 persona janë shëruar derisa 441 persona janë ende aktivë me koronavirus. Prej shpërthimit të pandemisë në mars të vitit 2020, autoritetet

shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar mbi 160 000 raste të infektimit. Prej këtyre, 2 977 persona kanë vdekur. Prej nisjes së fushatës së vaksinimit 730 037 persona janë vaksinuar plotësisht

kundër këtij virusi derisa 838 946 persona kanë marrë dozën e parë. Deri më 2 nëntor në orën 15:00 është vaksinuar plotësisht 40,6 për qind e popullsisë së përgjithshme.



Fadil Nura jep dorëheqje nga pozita e deputetit

SKENDERAJ, 2 NËNTOR - Fadil Nura ka dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit të Kuvendit të Kosovës pas fitores së zgjedhjeve lokale për kryetar komune në Skenderaj. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se do të jetë i

nderuar t'u shërbejë qytetarëve të Skenderajt. "Të dashur qytetarë, ju njoftoj se kam dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit në Parlamentin e Republikës, ku me përgjegjësi jam angazhuar për të mbrojtur përveç tjerash edhe interesat e komunës

sonë. Nderin e njëjtë do ta kem edhe tani t'ju shërbej, vetëm se me përgjegjësinë e kryetarit të Komunës, për çka mëzi pres të nisim angazhimet për punë të mëdha që na presin", ka shkruar Nura në llogarinë e vet në "Facebook".



Jetësohet projekti për trajtimin e personave me nevoja të veçanta

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Si pjesë e reformave gjithëpërfshirëse për avancimin e trajtimit të personave të privuar nga liria, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, së bashku me Ambasadën Amerikane, EULEX-in dhe Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, i cili vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, i kanë dhënë mbështetje projektit për trajtimin e personave me nevoja të veçanta.

Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta do të jetë i vendosur në Qendrën Korrektuese të Dubravës dhe do t'i mbulojë shërbimet shëndetësore të personave të privuar nga liria, veçanërisht grupeve të ndjeshme me nevoja të veçanta, ku pa rrezikuar sigurinë do të ofrohet kujdes shëndetësor adekuat profesional, ndërsa do t'i zvogëlojë në masë të madhe

transferimet jashtë institucioneve korrektuese për këto nevoja.

Ky institucion do të mundësojë trajtim human, dinjitoz, profesional dhe adekuat për këto kategori të personave me nevoja të veçanta: Njësia për trajtimin e personave me nevoja të veçanta, ku do të trajtohen të gjithë ata persona që kanë pengesa arkitektonike dhe të tjera shqisore, personat me proteza, karroca invalidore, pengesa në të parë dhe të dëgjuar, ata me paterica mbështetëse dhe të gjithë ata që kanë nevojë për mbështetje për funksione vitale; Njësia geriatrike: personat e moshuar që kanë nevojë për mbështetje dhe kujdes të vazhdueshëm; Njësia për trajtim të shtuar mental: personat që kanë rrezik të vetëvrasjes dhe që kanë çrregullime akute, të përkohshme, mendore; Njësia



për trajtimin e personave me sëmundje të varësisë: trajtimi i varësive, trajtimi zëvendësues terapisia okupuese dhe rehabilitimi; Njësia për trajtimin e sëmundjeve kronike; Trajtimi i personave me sëmundje kronike

me kujdes permanent shëndetësor, të monitoruar. Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve dhe partnerët ndërkombëtarë do të punojnë për vendosjen,

sistemimin dhe akomodimin për trajtimin e kësaj kategorie në bazë të nevojave dhe kërkesave të tyre, çdoherë duke u mbështetur në standarde të afirmuara ndërkombëtare dhe praktikant më të mira.

Gexha-Bunjaku dhe komandanti i KFOR-it: Vaksinimi kundër Covidit, i rëndësishëm



PRISHTINË, 2 NËNTOR - Ushtruesja e detyrës e ministres së Shëndetësisë, Dafina Gexha-Bunjaku, ka pritur të martën në takim mikpritës komandantin e ri të forcave paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë (KFOR), gjeneralmajor Ferenc Kajari. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë, ajo i ka uruar suksese gjeneralmajorit në detyrën e re dhe i ka shprehur mirënjohjen për rolin e KFOR-it në mbështetjen e vazhduar ndaj komuniteteve në Kosovë dhe asistencën e ofruar Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve

shëndetësore edhe gjatë pandemisë Covid-19. Në takim është biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional, të komunikimit të ndërsjellë dhe ndërveprimit institucional në shërbim të qytetarëve. Ministrja Gexha-Bunjaku dhe gjeneralmajori Kajari kanë vlerësuar se vaksinimi kundër Covid-19 dhe zbatimi i masave parandaluese nga përhapja e virusit është i rëndësishëm për ruajtjen e shëndetit publik të qytetarëve.

Rreth 1 000 stenta janë vendosur te pacientët gjatë pjesës së parë të këtij viti në OKUK

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka bërë me dije se gjatë pjesës së parë të këtij viti kardiologët invazivë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës kanë vendosur 996 stenta te pacientët. Po ashtu, ShSKUK-ja ka bërë

me dije se në sallat e Kardiologjisë Invazive brenda gjashtë muajve janë kryer edhe 1 736 procedura të koronarografisë. "Në mesin e shumë procedurave të tjera kardiologjike, mjekët kardiologë invazivë kanë ofruar edhe 303 shërbime të

ekoradiografisë dhe kanë realizuar edhe 4 ekokardiografi transezofageale. Pas qetësimit të situatës me Covid-19, Kardiologjia Invazive po kryen edhe rastet e planifikuara të koronarografive dhe tentimeve", ka njoftuar ShSKUK-ja.



Ministria e Drejtësisë do t'i ulë tarifat e përmbauesve privatë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka marrë pjesë në hapjen e punimeve të grupit punues për hartimin e Udhëzimit Administrativ për tarifave të përmbauesve privatë. Zëvendësministri Sallahu gjatë fjalës së tij ka thënë se ky grup është themeluar me qëllim të ndryshim-plotësimit të udhëzimit për tarifave të përmbauesve privatë duke

marrë parasysh vështirësitë dhe mangësitë tashmë të identifikuar në praktikën e zbatimit të tarifave të përmbaimit, në veçanti faktit se udhëzimi aktual lë hapësirë për interpretime rreth çështjes së gjenerimit të tarifave. Në mënyrë që të bëhen ndryshimet e duhura, Sallahu ka thënë se Ministria e Drejtësisë me mbështetjen e programit të USAID-it për drejtësi komerciale ka kryer analizën e studimit të kostove të shërbimeve përmbaimore nga


përmbauesit privatë si dhe analizën krahasuese të shërbimeve të përmbauesve privatë të Kosovës me ato të vendeve të rajonit. "Ministria e Drejtësisë ka vendosur që të ketë rishikim të tarifave, respektivisht ulje të tyre", është shprehur ai. Ndër të tjera, zëvendësministri Sallahu ka bërë me dije se, krahas procesit të rishikimit të tarifave, Ministria e Drejtësisë ka finalizuar edhe ndryshim-plotësimin e Ligjit për Procedurën Përmbaimore, i cili

adreson çështjen e ndarjes së barabartë të lëndëve të pranuar nga institucionet publike me qëllim të garantimit të funksionimit të zyrave përmbaimore, si dhe eliminimin e krijimit të monopoleve. Zëvendësministri Sallahu ka theksuar se Ministria e Drejtësisë mbetet e përkushtuar për përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit të sistemit të përmbaimit privat të Kosovës dhe ngritjen e besimit

të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Grupi punues udhëhiqet nga Ministria e Drejtësisë dhe në të marrin pjesë përfaqësues nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, përmbauesi privat, Oda e Avokatëve të Kosovës, Shoqata e Bankave të Kosovës, Oda Ekonomike e Kosovës, si dhe përfaqësuesi i projektit CILC që mbështet përmbaimit.

Ky proces mbështetet nga Programi për Drejtësi Komerciale i USAID-it.



Gjatë pandemisë Kosova u përball edhe me lajme të rreme

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 2 NËNTOR - "Demokrati Plus" (D+) ka publikuar raportin e shkurtër "Lajmet e rreme gjatë pandemisë Covid-19 dhe ndikimi i tyre".

Që nga shfaqja e rasteve të para me Covid-19 e deri më tani, në të gjitha vendet, përveç sfidës së ballafaqimit me këtë infeksion, shqetësim mbetet edhe ballafaqimi me lajmet e rreme rreth kësaj pandemie. Sipas "Demokrati Plus", nga këto lajme nuk ka mbetur pa u prekur as Kosova. "Lajmet e rreme kanë filluar të përhapen që nga fillimi i pandemisë duke shpikur 'mite' rreth prejardhjes së pandemisë Covid-19, si të mbrohemi nga infektimi e deri te efektet anësore të vaksinës. Përveç komenteve në rrjetin social 'Facebook' janë

formuar grupe antivaksinë të cilët bëjnë thirrje për mosvaksinim. Një prej këtyre grupeve quhet 'diskutime rreth vaksinës', shumica e profileve në këtë grup janë të rreme dhe nuk dihet qartë kush qëndron prapa tyre. Përveç formimit të grupeve, në Kosovë tendencë për përhapje të dezinformatave kanë edhe mediat online ku, sipas një hulumtimi nga NDI, që nga marsi i vitit 2020 deri në shkurt të vitit 2021, 3 613 postime në mediat online kanë përmbajtje me informacione të çrregullta", është thënë në raportin e "Demokrati Plus".

Sipas këtij raportit, pasojat që sjellin këto lajme të rreme mund të jenë: Shkaktimi i ankthit dhe stresit duke i vënë në mëdyshje për imunizim, e deri te bojkotimi total i vaksinës anti-Covid e që, si rrjedhojë, ka



shpërndarjen e virusit dhe shfaqjen gjithnjë e më shumë të varianteve të reja.

Disa nga rekomandimet e "Demokrati Plus" (D+) për ndalimin e përhapjes së lajmeve të rreme janë:

Ministria e Shëndetësisë duhet që në bashkëpunim me Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës, me mbështetjen e

agjencive donatore, të dizajnojnë një fushatë komunikimi ku ndikimi i dezinformatave dhe lajmet e rreme në pandeminë Covid-19 të jenë në fokus të fushatës; Fushata duhet të jetë e targetuar, për shembull, të synojë të rinjtë, ose mediat, rajonin e caktuar, grupmohën e caktuar dhe të japë mesazhet në përputhje me rrethanat;

Ministria e Shëndetësisë, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës dhe Policia e Kosovës duhet të bashkëpunojnë ngushtë për identifikimin e lajmeve të rreme duke përfshirë burimet e lajmeve të rreme dhe të koordinojnë luftën kundër lajmeve të rreme dhe dezinformatave; dhe Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës duhet të punojë vazhdimisht me mediat online për ta parandaluar publikimin e dezinformatave dhe lajmeve të rreme nga artikujt e përkthyer nga mediat ndërkombëtare. "Edukimi dhe trajnimi online për lajmet e rreme duhet të vihen në dispozicion të qytetarëve. Një shembull i mirë mund të jetë platforma e D+ për lajmet e rreme për të mësuar më shumë rreth dallimit midis lajmeve të vërteta dhe të rreme", thuhet në raportin "Demokrati Plus".

Rihapet terminali doganor i “Trepçës”

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

MITROVICË, 2 NËNTOR - Nga dita e martë është rihapur terminali doganor shtetëror brenda hapësirave të Ndërmarrjes Publike “Trepça” në Mitrovicë. Në ceremoninë hapëse, bashkë me kryeministrin e Kosovës, ish-in edhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli dhe drejtori i Doganës së Kosovës, Agon Llugaliu,

kryesuesi i bordit të “Trepçës”, Bahri Hyseni dhe ushtruesi i detyrës i kryeshefit ekzekutiv, Enis Abdurrahmani. “Sot është një ditë tejet e rëndësishme për të gjithë ne”, ka thënë Kurti në fillim të fjalës së tij. Ai ka theksuar se nga ky veprim i sotëm përfitojnë të gjithë, shteti i Kosovës, “Trepça”, Dogana e Kosovës, në veçanti bizneset. Kryeministri Kurti ka rikujtuar se nga viti 2003 deri në vitin 2014 ky terminal doganor ka qenë në hapësirën e “Trepçës”, por që padrejtësisht e çuditërisht kjo

hapësirë i është privuar “Trepçës” për terminal doganor dhe i është dhënë një kompanie private jashtë zonës së “Trepçës” duke bërë që çmimi për maune të rritej në 40 euro dhe në të njëjtën kohë gjithsej 24 punëtorë të ngelin pa punë. “Shtatë vjet më vonë ne po e bëjmë këtë hapje të terminalit doganor në hapësirën e ‘Trepçës’, po e rikthejmë në ‘Trepçë’ atë që gjithmonë i ka takuar ‘Trepçës’ e në këtë mënyrë po e korrigjojmë një dëm të bërë para shtatë vjetëve”, u shpreh kryeministri Kurti.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se rihapja e këtij terminali doganor nënkupton fitim shtesë për “Trepçën”. “Megjithatë ky fitim do të jetë vetëm si e hyrë komplementare për të sepse ‘Trepçës’ do t’i kthehet aktiviteti primar si minierë dhe shkritore për t’u rikthyer si motor i zhvillimit ekonomik të vendit”, ka thënë ai. Ministri Murati, po ashtu, ka ritheksuar se deri në mesin e vitit të ardhshëm terminalet e tilla shtetërore do të shtrihen në tërë

territorin e Republikës së Kosovës.

Ndërkaq, ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, u shpreh e kënaqur të shohë një avancim të rolit të ndërmarrjeve publike, përtej atij primar, në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve. Ajo ka thënë se ky është vetëm fillimi për “Trepçën” dhe se vëmendja e deritanishme dhe projektbuxheti i miratuar për të tregojnë për kushtimin e qeverisë dhe Ministrisë së Ekonomisë ndaj kësaj ndërmarrjeje të rëndësishme.



Odat Amerikane të Evropës, të përkushtuara për ndryshimet klimatike

PRISHTINË, 2 NËNTOR - Këshilli Evropian i Odave Amerikane, pjesë e të cilit është edhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, vlerësojnë se Samiti COP26 në Glasgow, në të cilin janë mbledhur liderët globalë për t’i përshpejtuar veprimet drejt arritjes së objektivave të marrëveshjes së Parisit, shënon një moment historik thelbësor për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta, ndërsa fillojmë t’i shohim pasojat konkrete të ndryshimeve klimatike në të gjithë globin. “Si përfaqësues të komunitetit të biznesit transatlantik në Evropë, Odat Amerikane të Evropës mbështetin plotësisht objektivat e konferencës COP26 si dhe objektivat e reduktimit të emetimeve të përcaktuara me

marrëveshjen e Parisit. Odat shprehin besimin se bashkëpunimi ndërkombëtar është thelbësor për t’i arritur objektivat globale të neutralitetit të klimës dhe se vetëm përmes dialogut të vazhdueshëm të përbashkët midis liderëve botërorë, nga vendet e zhvilluara te vendet në zhvillim, nga SME-të te korporatat globale, mund ta arrijmë kalimin në një ekonomi neutrale ndaj karbonit që do të sjellë përfitime për jetën e njerëzve”, është thënë në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane. Sipas kësaj komunikate, partneriteti transatlantik në agjendën e klimës do të jetë parësor. “Ndër emetuesit më të mëdhenj në botë, ekonomitë transatlantike duhet të



udhëheqin me shembull dhe ta përdorin ndikimin e tyre global për të sjellë aleatët dhe partnerët në garën drejt zeros neto. Në emetimin e bonove të gjelbra, Evropa dhe ShBA-ja tashmë po marrin drejtimin, pasi kanë emetuar 80 për qind

të të gjitha obligacioneve të gjelbra në vitin 2020. Industria tashmë po kontribuon në zbutjen e ndryshimeve klimatike në mbarë botën, duke zhvilluar teknologji të reja me karbon të ulët, duke mbështetur financimin e

gjelbër dhe duke reduktuar gjurmën e tyre mjedisore. Megjithatë, bashkëpunuesit janë të vetëdijshëm se duhet bërë më shumë dhe janë të gatshëm të punojnë së bashku me politikëbërësit për ta bërë të suksesshëm tranzicionin e gjelbër”, është theksuar në këtë komunikatë. Si blerësit kryesorë të energjisë së rinovueshme evropiane, komuniteti i biznesit transatlantik në Evropë ka qenë dhe mbetet i përkushtuar në mënyrë të palëkundur për të luajtur një rol në avancimin e objektivave të marrëveshjes së Parisit dhe për të arritur një tranzicion të suksesshëm të gjelbër që kombinon qëndrueshmërinë dhe prosperitetin.

Kuteli: Shuteriqi i vodhi e përllau veprat e Lef Nosit, në Beograd tha se rrjedh nga një familje e “Stara Serbisë” në Elbasan!

Mitrush Kuteli, në një letër që i drejton mikut të tij Musfata Greblleshi, i flet për Dhimitër Shuteriqin (gjyshin e Ben Blushit nga nëna). Aty ai e përmend Lef Nosit dhe veprën e tij. Kuteli e Greblleshi janë dy shkrimtarë të burgosur e të persekutuar nga regjimi komunist në Shqipëri, i cili regjim e vrau Lef Nosit – nënshkruesin e dokumentit të pavarësisë. Letra është si më poshtë:

I dashur Mustafa dhe e dashura motra Merushe,

Kjo e uruar letër u bë litar me krye, po pa fund.

Udhës takova shumë të njohur të mjitë dhe të babajt. Ndenjëm u çlodhëm në varret e sheshuar, duke pritur të dalë hëna, po kjo vonoi. Doruntina mërziptej, e kish lodhur shumë banja e ditës, udha. E mbajta pak në krahë pastaj e mori Eftëri. Zbritme. Hëna doli kur rrinim buzë liqenit: e madhe, e kuqe. Pastaj u zbardh, mori vrull e lundroi nëpër hapësirë. Fëmijët më vunë njëmijë e njëqind pyetje “Si është hëna? Ç’ka prapa atij mali? Po në Tiranë ka hënë tani? Është i madh ai yll? (Afërdita). Sa një shtëpi apo m’i vogël?”

Unë bluaja mendime të tjera: “Ç’është vallë kjo harmoni kaq e përsosur? Që ku vijmë e ku shkojmë? Sa rrëke njerëzish kanë shkelur në këto ranish dhe ku janë tani?” Dhe mendja më shkon me drithma tek ai që s’guxoj t’i përmend emrin, sepse jam tepër i vogël-hij’e një grimce të një stërgrimce – tek ai që ka shumë emra, por që është një i vetëm dhe mbi të gjitha dyshimet e mija birucore, dua me gjithë shpirt që të jetë, të mposhtë mohimet e mija dhe të më prehë atje ku dua vetë, atje ku thashë, në vetmi. O zot, duhet të jesh, sepse pa Ty nuk prehem dot!

Këndova pothuaj të tërë “Antologjinë poetike” të Viktor Hygoit, në përkthimin e “Sotir Cacit”. Me të vërtetë përkthimi është shumë i mirë.

Po kush e ka bërë këtë përkthim? Kjo është një punë e gëshme, e javashme, jashtë normave. Dhe ka një vandak të tërë fjalësh që s’janë të shqipëronjësit. Këto të gjitha po t’i them më kot: unë e di se kush e ka bërë këtë shqipërim, sepse kam parë dorëshkrimet dhe di se si u pjesëtuan ... paratë. Mistifikime, mercerizma të padenja për një njeri që shkruan. Sidoqoftë, unë s’e bëj dot, kurrë, kurrë!

Një ditë në Beograd, Shutja (Dhimitër Shuteriqi) më pat pyetur:

– Mitrush, ç’do bënje ti po të kishe gjetur një vepër të pabotuar të një shkrimtari të

vdekur?

– Ia ktheva: – Do t’i bëja një parathënie dhe do ta botonja.

– Ay: – Me emrin e kujt?

– Të atij që e ka shkruar. Unë do të kënaqesha t’i jap lexonjësit një vepër që mund të zhdukej.

– Jo, – më tha, – vepra e gjetur është imja, se unë e gjeta. Pra, unë, gjetësi, jam “autori” i saj.

– Ti s’je autor, se nuk e brumose në mendje e shpirt, nuk vuajta në të lindurat, nuk ... nuk.

Ay më shikoi tinzar dhe e ktheu fjalën:

– Po kur e boton një këngë popullore?

– Kur e botoj një këngë popullore, them se ku e kam mbledhur, kush ma ka treguar. Roli im është ta mbledh, ta botoj, t’i tregoj burimin.

Ay përsëri: – Po ay që ta dha këtë këngë, s’është autori i saj, pra ...

– Unë s’them që filani e ka qitur këtë këngë, them se ay ma ka treguar. Po të mund, shtoj ku e ka dëgjuar, kush e këndonte etj. Shutja e ktheu prapë, kategorikisht: – Jo, s’jam dakord. Vepra që kam gjetur është imja. Po të mos isha unë, kushedi, do të humbiste. Pra, unë e gjeta dhe do ta botoj me emrin tim.

I thashë: – Kësaj i thonë vjedhje ...

Ay u ngrys. Kështu u mbyll muhabeti ynë në rrugët e Belgradit, në dhjetor 1945.

Atëherë Shutja ish mjaft modest, por brenda tij gurgullonte kazani i madh i shejtanit. Lëvdonte shkrimet e mija, ngrinte në qiell Lame Kodrën. Pastaj nisi të ngrihet, gjersa u bë burrë me llullë, me bére e me automobil, më shau e përshau, pështyu, lëpiu, hoqi “i”-në në fund të emrit që të vërtetonte tezën e tij, siç i tha vetë Popoviqit në tryezë: “Emri ynë vjen nga fjala serbe ‘shute’, që do të thotë ‘shaka’. Rrjedhim nga një familje e ‘Stara Serbisë’ të ‘Despotatit të Elbasanit’. Pra, si të thuash, ‘unë’ jam ‘ti’, ndihmome të ngrihem lart, jepmë, të kam vëlla”.

Po si u bë puna e asaj veprës së “gjetur”? Para ca kohësh botoi “Gjorg Golemin” që bje erë Lef Nosi.

Me të vërtetë Shutja – shejtani, karasyfeti më karavidhe që ka nxjerrë qyteti – kërthizë, kameleoni arrogant, më vjedhës, më vjedhacak, më vjedhacak, hajdut me damkë i botës shpirtërore (medet, edhe i botës lëndore), fjalacuku më i ndyrë midis gjithë fjalacukëve dështakë (epitetet që gurgullojnë nga realiteti nuk kanë të sosur) – përllau dikur tërë dorëshkrimet e Lef Nosit, të Sotir Kolesë etj., të mbledhur çikë-çikë një jetë të tërë dje, tani, ose nesër i paraqet ose do t’i paraqesë si të tijat, duke mos



harruar të verë midis emrit të tij dhe të familjes (Shute të Stare Serbisë, siç thënkuan serbët e Elbasanit dhe Pogradecit tim, duke tjerur ëndrrën serbomadhe të një perandorie të re, qoftë edhe republikane, të Serbisë midis tre deteve), shkronjën e madhe “S” të babajt që vodhi veprën “Varri i dashnorëve” të Naum Voillës, duke e paraqitur si të vetën ...

E pra, këtu në Pogradec ka qenë dikur një djalosh që i thoshin Pirro Vako, një nga të rinjtë e parë komunistë, ëndërrimtarë të një bote të drejtë, pa shfrytëzim, pra, pa vdekje. Pirro Vakua kish patur një dell të mirë shkrimtari. Dikur më pat thënë: “Ti ke rënë, po unë të nderoj e të dua, se më ke treguar udhën si të shkruaj”. Dhe zbrazti një gotë raki. Ay dështoi në jetë (një punë dashurie me një vajzë që quhet Izmini, flokëverdhe, të cilën ju – ti dhe Rushi – e shihni dëndur nëpër Tiranë), iu dha alkoolit, vuajti e vdiq. Shutja i vajti babajt të këtij, i premtoi dhenë e qiellin, mori një dhomë me qira në shtëpi të tij dhe i përllau – në mënyrë shuterore – tërë dorëshkrimet (ditare lufte, shënime, tregime etj.). I ati pret akoma që Shutja t’i botojë këto të gjithanë emrin e djalit. Shutja ndofta i boton, po me pikëpamjet e dyzetepesës, për të cilat fola më lart: me emrin e vet, për xhepin e vet ... Para ca vitësh i vodhi një prifti këtu (prifti vdiq vjet) regjistritin e shënimeve të një manastiri. Prifti më thosh: “Ia rrëfeva, e pa, më lëvdoi, pastaj ma dha prapë, ma mori përsëri, ma dha dhe njëherë dhe unë e vura nëvend. Kur iku, s’e gjeta më ...”

Prifti bënte kryq, sikur donte të largonte shejtanin: “Ma vodhi, bre, s’pandenja, paska qenë...” Kockat e Papandonit (kështu i thoshin priftit) po treten tani në gështenjat, kurse Shutja shuteron “tani përsëri me “i”-në në fund të emrit”, më shikon vëngër, siç e vështron kalorësi

këmbësorin e çalë apo më mirë automobilisti arrogant udhëtarin e mjerë. Dhe përsëri më kujtohen vargjet e Khajamit: Rrëmyen mall, memuriet e ar, Dhe t’irtin plak, të urtin shkëncëtar E quajnë gjaur, se s’beson prralla, Se s’qas mbi supe, si ata, samar. Më falni se u zgjata kaq shumë me këtë “Dhimitriadë Shuteriqore”, po këto të gjitha m’i zgjoi karasyfeti i tij arrogant që endej rrugëve të Pogradecit.

Kam dhe diçka tjetër.

Lef Nosi ka pasur një koleksion të pasur me pulla poste të vjetëra, të mbledhura me kujdes një jetë të tërë (në qeverinë e Vlorës, të Ismail Qemalit, kishte qenë ministër i Postave). Shutja mori dorëshkrimet e tij dhe një pjesë të bibliotekës (librat ia kam parë me sytë e mij në hotel “Dajti”, ku banoi një kohë, më 1945 dhe 1946). Po ç’u bënë albumet e pullave që vlejné, pa ekzagjerim, miliona lekë? Është fjala për pulla të rralla të Turqisë me syrsharzhimin e Hyrjetit dhe sidomos atë të qeverisë së parë të Vlorës, është fjala për pullat e qeverisë së parë të Vlorës, është fjala për pullat e qeverisë së Durrësit, për ato të mbretit Vid e sa e sa të tjera.

Kush i mori, kush? Këto duhej t’i merre shteti dhe, me sa di unë, Shutja, ndonëse mban berë shkrimtari (që ta tregojë bota me gisht) s’është shtet. Kisha dhe mjaft të tjera për këtë individ cipëplatur, por nuk po vazhdoj: më vjen ndot. Falmëni!

Në këtë kohë kam lexuar disa libra dhe kam rilexuar disa tregime të asaj suedeze së ëmbël e të qetë, Selma Lagerlöf, me një botë morale që s’i ngjet fare botës sonë gjaknxehtë, vrasëse, ballkanike. As e ndjera Selma Lagerlöf s’i ngjet (luaj vendit) Shutes. Dhe mu kujtua një film shumë i dashur: “Gösta Berling” pas veprës së parë të mësonjëses Selma Lagerlöf. E ka lojtur dikur Greta Garbo. Ka qenë një film pa zë (para se të

fillonte krokëritja e saksofonit dhe bubullima e artilerisë në sallat e kinemasë), po kaq i fortë, kaq i bukur! Tani, Greta Garbo është plakë, po unë e përmend se më ka lënë mbresa të thella në kujtesë.

Rilexova edhe “Souvenir de la Haute-Albanie” të A. Degrandit, dikur konsull i Francës në Shkodër (Botim i 1901). Libri është shkruar më 1893-1899 (sot librat nxirren shpejt e shpejt, si qerpiçët nga kallëpi e vihen në mur para se të përthahen).

Ky libër më ngjalli hidhërim të mëdha: vëllavrasje, fantazma, urrejtje, që e bluan e stërbluan jetën tonë shqipëtare. Na pakësuan dhe na ngjeshën në një cep të Ballkanit, ndonëse kemi qenë zotër të moçëm të një vendi të madh, shumë larg këtyre caqeve, ku jemi mbytur sot.

Të huajtë na mbuallë urrejtjen, na ndanë e përçanë, na bënë të mos e njohim veten, të mos e duam veten, domosdo as vëllanë. Tani, thotë Degrandi, njerëzit urrejnë njëri-tjetrin në çdo vilajet, greku mbjell farën e grindjes në Epir; Austria, Italia – në Veri; Mali i Zi, i përkrahur nga Rusia, gjithashtu. Në krahina të tjera serbët, bullgarët, bilë dhe rumunët kanë dërguar njerëz për të çarë e përçarë.

Një grek i moçëm me emrin Phrantjes, historian, paska thënë: “Shqiptarët janë populli më i lik dhe më i kotë (“le plus inutile”) në botë”. Përfundimi? Duhet të zhduket ... Kështu thotë bizantini Phrantjes. Domosdo Phrantjes është armik, është ujk dhe ka folur, shkruar e vepruar ndofta si ujk. Por ujku njihet dhe njeriu di sesi të mbrohet kundër tij, me sëpatë, me kopaçe. Por si të mbrohet kundër ujkut të veshur me lëkurë dele? Si të mbrohet kundër atij që i flet si ëngjëll e vepron si shejtan?

Të gjitha këto i lexoj, i bluaj në mendje natën dhe s’më zë gjumi dhe më vjen të çmendem! ... Nesër Eftëri do të nisat me gjithë fëmijë.

Unë do të rri dhe ca ditë, do ta pres Sterjo Spassen, do ta vendos në dhomë, pastaj do të kthehem në Tiranë. Këtu nuk u preha dot. Pashë gërmadhat e shtëpisë plot ferra dhe mu drodh zemra. Jo, Pogradeci s’është më për mua të gjallë, po për mua të vdekur. Ah, kush ndjen shumë, vuan shumë. Shto pastaj brengat objektive, fëmijët varfërinë e sa të tjera. Do të vij të “çlodhem” në Tiranë, t’i vihem normës, se mos më presin bukën.

Lamtumirë dhe përqaqime vëllazërore, Mitrushi

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Liverpooli kërkon fitoren e dytë ndaj Atletico, Milani kërkon shansin e fundit kundër Portos

"Epoka e re"

LIVERPOOL, 2 NËNTOR - Skuadra e Liverpoolit do të synojë të fitojë edhe ndeshjen e dytë kundër Atletico Madridit kur këto dy skuadra përballen sonte (e mërkurë) në "Anfield" në kuadër të Grupit B në Ligën e Kampionëve. "Reds" e mposhti Atletico në ndeshjen e parë me rezultat 3-2 në "Wanda Metropolitano" muajin e kaluar, por në fundjavë barazoi 2-2 kundër Brighton & Hove Albion, ani pse kishte epërsinë e dy golave.

Liverpooli me një fitore eventuale do ta sigurojë kualifikimin dhe vendin e parë në grup, por kampionët e Spanjës do të përpiqen që të marrin një rezultat të favorshëm në mënyrë që të mbesin në garë për kualifikim në fazën tjetër. Naby Keita është rikthyer nga lëndimi, por mungojnë James Milner dhe Harvey Elliott, derisa në dyshim janë Fabinho dhe Thiago Alcantara. Griezmanni, Saviqi dhe Llorente janë mungesat për këtë



ndeshje, kurse Thomas Lemar është përjashtuar nga trajneri Simeone.

Edhe ndeshja tjetër e këtij grupi mes Milanit dhe Portos pritet të jetë shumë interesante. Kuqezinjtë e Italisë po gëzojnë formë të mirë në Serinë A, por në Ligën e Kampionëve nga tri ndeshje kanë pësuar tri humbje. Trajneri Stefano Pioli ende nuk i ka humbur shpresat për kualifikim. "Do të jemi përballë Portos. Duhet të jemi të përqendruar dhe të luajmë lojën tonë siç dimë të bëjmë në Serinë A. Kemi fatin e keq që kemi rënë

në grupin më të vështirë, por justifikime nuk duhet të nxjerrim. Kapacitetin e kemi, por na mungon pak fati. S'duhet të bëjmë gabime. Ndodhemi në vendin e fundit me zero pikë dhe kjo gjë na shqetëson shumë. Nuk ka mbetur gjë tjetër vetëm të shtrëngojmë dhëmbët dhe ta bëjmë maksimumin në këto ndeshje që kanë mbetur. Asgjë s'ka mbaruar ende dhe ne do të provojmë deri në fund. Kemi shumë për të rregulluar dhe do të tentojmë ta nisim ndaj Portos, më pas do të mendojmë për derbin ndaj Interit të dielën sepse e dimë se çfarë na

pret", ka thënë Pioli.

Në Grupin D Real Madridi e pret Shakhtarin dhe pret tri pikë për t'i ruajtur gjasat për kualifikim, pse jo edhe për ta marrë pozitën e parë nëse Sheriffi dështon kundër Interit. Leipzig pret pikët e para në përballje kundër Paris Saint-Germainit, që në këtë ndeshje do të ketë mungesa të rëndësishme si

ajo e Messit, Ramosit dhe Verrattit. Skuadra franceze, pavarësisht prej mungesave, do të përpiqet t'i marrë tri pikë në Gjermani dhe ta vazhdojë dominimin në Grupin A. Ndërsa skuadra kampionë e Anglisë, Manchester City, e pret Club Brugge nga i cili synon t'i marrë tri pikë dhe t'i afrohet edhe më shumë kualifikimit.

GRUPI A		GRUPI C	
21:00 Manchester City - Club Brugge 21:00 Leipzig - Paris Saint-Germain		21:00 Borussia Dortmund - Ajax 21:00 Sporting - Besiktas	
Tabela		Tabela	
1. PSG	7 pikë	1. Ajaxi	9 pikë
2. Manchester City	6	2. Borussia Dortmund	6
3. Club Brugge	4	3. Sporting	3
4. Leipzig	0	4. Besiktas	0
GRUPI B		GRUPI D	
18:45 Milan - Porto 21:00 Liverpool - Atletico Madrid		18:45 Real Madrid - Shakhtar D. 21:00 Sheriff - Inter	
Tabela		Tabela	
1. Liverpool	9 pikë	1. Sheriff	6 pikë
2. Atletico M.	4	2. Real M.	6
3. Porto	4	3. Interi	4
4. Milan	0	4. Shakhtar	1

Llapi kërkon 'hakmarrje' ndaj Malishevës



PODUJEVË, 2 NËNTOR - Skuadra e Llapit po kërkon "hakmarrje" kundër Malishevës për humbjen në ndeshjen e parë të këtij edicioni që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri" (0-3). Ndeshja në mes të Malishevës dhe Llapit zhvillohet të shtunën në stadiumin "Liman Gegaj".

"Serinë e rezultateve pozitive në ndeshjet si mysafire, skuadra e Llapit synon ta vazhdojë edhe në ditën e shtunë në përballjen me Malishevën, duel i javës së 13-të që do të zhvillohet në stadiumin 'Liman Gegaj'. Skuadra e Llapit është skuadra e dytë pas Dritës me formën më të mirë në

ndeshjet si mysafire me gjithsejtë 10 pikë të grumbulluara nga 15 në total, 4 fitore në total prej tyre 3 si mysafire (Prishtina 1-2, Ulpiana 0-6, Feronikeli 0-2) e renditin Llapin prapë në vendin e dytë sa iu përket ekipeve me më së shumti fitore si mysafire,

skuadra e Malishevës i ka dhënë humbjen më të thellë Llapit në këtë edicion, 0-3 në 'Fadil Vokrri'. Skuadra e Llapit ka serinë prej 4 fitoreve në 5 ndeshjet e fundit, kurse skuadra e Malishevës prej 4 humbjeve rresht në 5 ndeshjet e fundit", thuhet në njoftimin e Llapit.

EHF-ja vlerëson rritjen e Kosovës në hendboll

PRISHTINË, 2 NËNTOR - "Kosova është përmirësuar shumë gjatë viteve të fundit". Kështu shkruan faqja zyrtare e Federatës Evropiane të Hendbollit (EHF). EHF-ja ka paralajmëruar

ndeshjet e fazës së parë kualifikuese për Botëror, ku paraqitet edhe Kombëtarja jonë. Ndeshjen e parë, Kosova e luan ndaj Turqisë, të mërkurën në Eskishehir. Ndërkohë të dielën

në Prishtinë është ndeshja me Belgjikën. Atmosfera në përfaqësuese është e jashtëzakonshme dhe këtë e kanë konfirmuar si shtabi teknik ashtu edhe lojtarët. Një ndeshje

e mirë dhe një rezultat i favorshëm ndaj Turqisë, do të ishte me peshë shumë të madhe për Përfaqësuesen e Kosovës. Synimi mbetet njëra prej dy vendeve të para në grup dhe

avancimi në raundin e dytë kualifikues. Katër ndeshje tjera luhen në janar. Pos me Turqinë në shtëpi dhe me Belgjikën në udhëtim, në janar i kemi edhe dy ndeshje me Greqinë.

Ardi Shala, 'Ylli i javës' në Superligë

LIPJAN, 2 NANTOR - Federata e Futbollit e Kosovës sa bashku me sponsorin e Superligas, Bankan Kombatare Tregtare BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës" par lojtarin ma ta mira ta xhiros.

"Ylli i javës" par xhiron e 12-ta na BKT Superliga ashta shpallur futbollisti i KF Ulpiana, Ardi Shala. Mesfushori i ekipit lipjanas dha kontribut ta madh na triumfin e skuadras sa tij ndaj

FC. Ballkani qa deri para kasaj xhiroje ishte lider na renditje. Shala fillimisht shanoi autogol, por na fund u ba hero i ndeshjes, duke e shanuar golin e fitores par skuadran e tij na kohan

shtesa. Kjo fitore e nxori Ulpianan nga zona e kuqe na BKT Superliga. Çmimin "Ylli i javës" par mesfushorin e Ulpianas e dha Naim Zeqiri, menaxher i degas sa BKT na Lipjan.



Conte emërohet trajner i Tottenhamit

LONDËR, 2 NËNTOR - Antonio Conte është emëruar edhe zyrtarisht trajner i Tottenham Hotspurit. Në këtë mënyrë strategu italian rikthyet në Premierë Ligë, aty ku e kishte drejtuar në

vitin 2018 skuadrën e Chelsea. "Spurs" e shkarkoi trajnerin Nuno Espirito Santo pas humbjes 3-0 nga Manchester Unitedi. "Jemi të lumtur të njoftojmë emërimin e Antonio Contes

në pozitën e trajnerit. Ai ka nënshkruar një kontratë deri në verën e vitit 2023, me opsion për ta vazhduar", thuhet në njoftimin e "Spurs". Conte ishte trajner i lirë, pasi në verë ishte

larguar nga skuadra e Interit, skuadër të cilën e kishte shpallur kampione në Itali. 52-vjeçari me sukses i ka drejtuar edhe Chelsea, Juventusin, Atalantën si dhe Kombëtaren e Italisë.



KOK-u nënshkruan memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës

Prishtinë, 2 nëntor - Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK) ka nënshkruar sot memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës, konkretisht Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit (FEFS). Memorandumi u nënshkrua nga presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi dhe dekani i FEFS-it, Musa Selimi, i cili njëherësh është edhe anëtar i bordit ekzekutiv i KOK-ut. "Memorandumi parasheh bashkëpunimin mes dy institucioneve në bashkërendimin dhe koordinimin e aktiviteteve të KOK-ut, si: organizimi i konferencave shkencore, konferenca Mjekësia dhe Sporti, por edhe në edukimin e trajnerëve, administratorëve sportivë, gjyqtarëve etj", thuhet në njoftimin e KOK-ut.



Presidenti Krasniqi dhe dekani Selimi kanë vlerësuar lart bashkëpunimin në mes të KOK-ut me UP-në, bashkëpunim ky që do të fuqizohet edhe më shumë me organizimin e aktiviteteve të përbashkëta. I pranishëm në takim nga KOK-u ishte edhe sekretari i

përgjithshëm Besim Aliti, edhe udhëheqësit e Akademisë Olimpikë, Fitim Arifi e Diellza Kelmendi, ndërsa nga FEFS ishin sekretari Gani Ibrahim, prodekani Florian Miftari dhe profesori Bujar Turjaka, i cili njëherësh është edhe anëtar i BE të KOK-ut.

Toronto befason Nju-Jorkun

Nju-Jork, 2 nëntor - Mbrëmje e mbushur me ndeshje me rastin e 75-vjetorit të themelimit të NBA-së. Në "Madison Square Garden" të Nju-Jorkut u zhvillua një nga përballjet më të forta mes Nicksin dhe Raptorsit, e fituar 104-113 nga skuadra kanadeze falë paraqitjes së jashtëzakonshme të OG Anunoby, autor i 36 pikëve, pa harruar edhe performancën e Gary Trent Jr. me 26 pikë në total. Për Raptorsin ishte suksesi i katërt radhazi dhe i pesti në tetë takimet e këtij fillim sezoni. Të pamjaftueshme për Nicksin 27 pikët e RJ Barrettit dhe 22 të Julius Randles. Ruan kryesimin në Konferencën e Lindjes Chicago Bulls, i cili regjistroi suksesin e gjashtë, duke iu imponuar 128-114 Boston Celticsit me "TD Garden Arena". Plot 37 pikë realizoi DeMar DeRozan në



REZULTATET

CHARLOTTE HORNETS - CLEVELAND CAVALIERS 110-113
INDIANA PACERS - SAN ANTONIO SPURS 131-118
PHILADELPHIA 76ERS - PORTLAND TRAIL BLAZERS 113-103
ATLANTA HAWKS - WASHINGTON WIZARDS 118-111
BOSTON CELTICS - CHICAGO BULLS 114-128
NEW YORK KNICKS - TORONTO RAPTORS 104-113
MEMPHIS GRIZZLIES - DENVER NUGGETS 106-97
MINNESOTA TIMBERWOLVES - ORLANDO MAGIC 97-115
LOS ANGELES CLIPPERS - OKLAHOMA CITY THUNDER 99-94

një sfidë që u vendos falë një rezultati të pjesshëm 11-39 në periodën e fundit. Për Celticsin spikati me 28 pikë Jaylen Browni. Philadelphia 76ers mposhti

Portland Trail Blazersin 113-103 me shtatë basketbollistë të skuadrës nga Pensilvania me numër dyshifror pikësh, mes të cilëve spikati Seth Curry me 23 pikë. Sukses edhe për Los Angeles Clippersin që kaloi 99-94 Oklahoma City Thunderin që, pavarësisht startit të mirë, lëshoi shumë terren në minutat në vazhdim. 32 pikë realizoi Paul George, që iu afrua "double-double", pasi kontrollloi 9 topa dhe dha 7 asistime.

SHKURT

Nadali zbulon planin për 2022-shin, shënjestron Australian Open

Tenisti spanjoll Rafael Nadal ka zbuluar objektivat për të ardhmen. Ish-numri 1 në botë, fitues i 20 grand slameve, nuk luan që nga gushti i këtij viti, pasi disa probleme në këmbë e detyruan ta ngrejë "flamurin e bardhë". "Plani im është që të luaj në dhjetor në Abu Dhabi, në turneun parapërgatitor dhe më pas një tjetër turne para se të luaj në Australian Open. Unë po punoj fort për të realizuar këtë plan dhe të jem në formën më të mirë të mundshme në Australi", ka thënë Nadal. "Unë nuk e di ende saktësisht se kur do ta nis stërvitjen me raketën, por objektivi im është të nis sezonin e ri që në janar. Dëmtimi nuk është rikuperuar ende 100%. Aktualisht stërvitem 90 minuta në ditë dhe kjo është pozitive. Aktualisht kam më shumë ditë që janë pozitive sesa negative dhe kjo më ngushëllon", ka shtuar Nadali.

Zidane është tifoz i Marseillet, por nuk e përjashton kalimin te PSG-ja

Zinedine Zidane e ka një peng. Lojtari e më pas trajneri që ka fituar gjithçka në karrierën e tij, i është kthyer kohës dhe e ndien se diçka i mungon. Si çdokujt, në fakt. Pengu i karrierës së tij si futbollist është Marseille. Duke folur për "La Provence", Zidane ka folur për klubin e zezës. "Një peng për mua mbetet fakti që nuk munda ta vishja asnjëherë fanellën e Marseillet. Kjo është skuadra e zezës, por ishin të shumta arsyt që e bënë të pamundur transferimin tim në ekip", ka thënë "Zizu". Por tani si trajner ai nuk e ka fshehur se një ofertë nga PSG-ja do ta tundonte. "Jam marsejez dhe i tillë do të mbetem gjithë jetën, por në futboll kurrë mos thuaj kurrë", ka deklaruar Zidane, duke iu referuar një emërimi të mundshëm si trajner i PSG-së.

Erikseni mund të transferohet në Ajax

Christian Eriksen dhe drama që përjetoi në "Euro 2020" bënë xhiron e botës, imazhe që vështirë se do të harrohen nga tifozët. Fantazisti danez ka lënë pas atë histori trishtuese, tani është koha për të parë nga e ardhmja dhe të rikthehet të bëjë atë që dëshiron më shumë, të luajë futboll. Zyrtarisht Eriksen është ende nën kontratë me Interin, por danezi e ka të pamundur të luajë në Serinë A për shkak të ligjeve në Itali. Sipas "Corriere dello Sport", Erikseni dhe Interi po shkojnë drejt zgjidhjes së kontratës, për të bërë të mundur që danezi të transferohet në Holandë. Gjithnjë sipas së përditshmes italiane, Erikseni do të transferohet tek Ajaxi, skuadër ku aktivizohet një tjetër lojtar me probleme kardiale si Daley Blind.

Dortmundi i vendosur për ta mbajtur Haalandin

Drejtori sportiv i Borussia Dortmundit, Sebastian Kehl, ka thënë se do të bëjnë gjithçka që ta mbajnë në skuadër sulmuesin Erling Haaland. Norvegjezi ka klauzolë lirimimi me vlerë 75 milionë euro verën tjetër dhe kërkohet nga top-gjigantët evropianë. Por, Kehl për "Bild" bën me dije se do të bëjë gjithçka për ta bindur Haalandin ta vazhdojë kontratën. "Jemi duke provuar të bëjmë gjithçka të bindim djaloshin që jemi një ndër zgjedhjet më të mira që të rritet, këtu mund të përmirësohet dhe ne mendojmë se mund ta bindim, sigurisht do të luftojmë dhe do të bëjmë gjithçka që të vazhdojë këtu. Vendimi ende nuk është marrë, na duhet kohë", ka deklaruar Kehl. Ndërkohë, klubet si Real Madridi, Barcelona, Manchester City, Manchester Unitedi, Juventus, Interi, Chelsea dhe Bayern Munich e duan qëndruesulmuesin.

Vinicius: Adhuroj Neymarin, por s'jam tifoz i Barcelonës

Mediat raportuan se braziliani Vinicius Junior është tifoz i Barcelonës dhe që donte kalimin në "Camp Nou" para se t'i bashkohej Real Madridit në çastet e fundit. Por, Vinicius thotë se

nuk ka qenë asnjëherë tifoz i Barcelonës, thjesht ka admiruar Neymarin, njësoi siç pëlqen edhe tani dhe yllin e Manchester Unitedit, Cristiano Ronaldo. "Asnjëherë nuk kam qenë

tifoz i Barcelonës. Gjithmonë e kam admiruar Neymarin, kudo që shkonte dhe njerëzit ndonjëherë e keqkuptojnë. Jam dhe gjithmonë kam qenë tifoz i Real Madridit. Nuk është që

e mbështes PSG-në ose Manchester Unitedin sepse jam tifoz i Neymarit dhe Ronaldos. Është admirim për idhujt e mi. Dua t'i bëj tifozët e lumtur. Real Madridi më ofroi më pak

para, por më besoi dhe më dhuroi projektin më të mirë", ka thënë Vinicius. Ndërkohë, Vinicius është duke shkëlqyer nën urdhrat e Carlo Ancelottit këtë sezon te klubi madrilen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Auto Sallon Behari” SH.P.K. me pronar Nehat Haliti, Dumnica e Llugës, Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811571670, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Auto Sallon Behari” D.O.O. Nehat Haliti, Dumnica e Llugës, Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811571670 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Auto Sallon Behari” L.L.C. Nehat Haliti, Dumnica e Llugës, Vushtrri, has come to the decision to quit its business: nr. 811571670 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Astrit Sahiti shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Liria” Pogradje kl . I deri VIII.

▶ Adea Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.M.L.P. “ Kadri Kusari”.

▶ Genti Nura nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit “Mehmet Akif” në Prishtinë.

▶ Anita Dedaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U. “At Gjergj Fishta” nga kl. XI-IX.

▶ Fisnik Vehapi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

▶ Vjollca Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. “Mazllum Këpuska”.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

